



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data	06-03-2018	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01	60/01-6977	-1-	



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-**

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së II (Parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 24 Shkurt 2018.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e II (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë : 28 Shkurt 2018:

1. Vendimi për Plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Vendimi të KK për formimin e Komitetit të Komuniteteve;
3. Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB);
4. Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, për shpenzim me buxhetin e vitit 2018;
5. Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRU " Bifurkacioni " – Sh.A. Njësia në Kaçanik;
6. Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM " Pastërtia " – Sh.A. Njësia në Kaçanik;
7. Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusave" SH.A. Kaçanik;
8. Vendimi për formimin e Komisionit për emërimin dhe riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale;
9. Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesës së parcelës kadastrale Nr. 00246-0, Z.K Soponicë, e evidentuar në emër të Esat Xhemal Guri nga f. Nikaj, për zgjerimin e lokacionit të varrezave të dëshmorëve;
10. Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës kadastrale Nr. 01507-0 në vendin, "Guri i Zi" Z.K Biçec, PSH, Ekonomia Pyjore në Kaçanik, për ndërtimin e objekteve publike;
11. Vendim paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00565-0, Arë e klasës të 3 (Tretë), ZK Bob, në emër të Esat Dema
12. Vendim paraprak për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela kadastrale Nr. 00203-5, Arë e klasës të 3 (Tretë), ZK Bob, në emër të Kemajl Dema; dhe
13. Vendimi për ndërrimin e destinimit të ngastrave kadastrale 183-2; 183-1; 182-0; 180-6; dhe 180-7, në ZK Bob, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore- zonë ndërtimi, banim e afarizëm.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komune e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal of Kačanik

01 Nr. 60/01-5524/2018
Kaçanik, 28. 02. 2018

Në bazë të nenit 51 dhe 52 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 39.1 të Statutit të Komunës, në zbatim të pikës 3 të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr. 60/01-1785/2018 të datës 24 Janar 2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik, me datë 28 Shkurt 2018, mori këtë :

V E N D I M
PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR
POLITIKË DHE FINANCA

1. Me këtë Vendim plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës, për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) 01 Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018 me dy anëtarë në rubrikat e zbrazura të pikës 2 paragrafët, 2.4 dhe 2.5 nga dy subjektet politike të përcaktuara; Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me një (1) anëtar dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me një (1) anëtar, si vijon:
 - 1.1. Nga Subjekti Politik i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) anëtar i KPF emërohet,
Ekrem Kyçyku,
 - 1.2. Nga Subjekti politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) anëtar i KPF emërohet,
Selim Reka.
 - 1.3. Pika 2.6 e Vendimit 01 Nr. 60/01-1785/2018 të Kuvendit të Komunës i datës 24 Janar 2018, ndryshohet dhe plotësohet si vijon; nga Komiteti për Politikë dhe Financa, hiqet, **Hajredin Luta**, ndërkaq në vend të tij emërohet, **Albana Troni**, nga subjekti politik i AAK, për shkak të balancimit gjinor.
2. Me ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit për Formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa, është si vijon:

1. Kemal Mërseli,	nga PDK	Kryesues sipas funksionit,
2. Nexhat Loku	nga PDK	anëtar,
3. Pranverë Loku-Zharku,	nga PDK	anëtar,
4. Ekrem Kyçyku	nga LVV	anëtar,
5. Selim Reka	nga LDK	anëtar,
6. Albana Troni	nga AAK,	anëtar, dhe
7. Hafize Sallahi	nga NISMA	anëtar.
3. Pikët të tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.
4. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit 01 Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës - MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01-6406 /2018
Kaçanik, 28.02.2018

Në bazë të nenit 51 dhe 53 të Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 39.1 të Statutit të Komunës, duke vepruar sipas Shkresës së MAPL Nr. 020/144/3 të datës 02.02.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 28 Shkurt 2018, mori këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

1. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet pika 2. e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-1787/2018-për formimin e Komiteti për Komunitete i datës 24 Janar 2018, ashtu që në Komitetin për Komunitete shtohet numri edhe për 2 anëtarë, nga 5 anëtarë sa ishte, bëhet përbërja 7 anëtarë, me anëtarësim, një anëtar nga Kuvendi i Komunës dhe një anëtar nga OJQ, si vijon:
 - 1.1. Nga Kuvendi i Komunës për anëtar të Komitetit për Komunitete emërohet, Hajredin Luta,
 - 2.2. Nga OJQ –Kryqi i Kuq - Dega në Kaçanik, për anëtarë të Komitetit për Komunitete emërohet, Naim Hysa.
2. Me ndryshim plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës të potencuar si në pikën paragrafit 1.1 dhe 1.2. të pikës 1 të këtij Vendimi, Komiteti për Komunitete, do të jetë në përbërje, 7 anëtarë, si vijon:

1. Lirije Luta,	nga PDK	anëtar,
2. Kaltrina Tafili	nga LVV	anëtar,
3. Nazife Krasniqi	nga LDK	anëtar,
4. Hajredin Luta	nga AAK	anëtar,
5. Shemsedin Abazi	nga KDMLNJ	anëtar dhe
6. Elmihane Krasniqi-Malsiu	nga HANDIKOS	anëtar.
7. Naim Hysa	nga Kryqi i Kuq	anëtar.
3. Pikët tjera të Vendimit mbasin të pandryshuara.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Anëtarët e Komitetit për Komunitete, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërsoli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01-Nr.104/01-1879/18
Kaçanik, 28.02.2018

Në mbështetje të nenit 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenit 6 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 28 Shkurt 2018, mori këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi(KKSB)

1. Me këtë Vendim, themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Kaçanikut.
2. Përbërja e KKSB është :
 1. Kryetari i Komunës - Kryesues,
 2. Komandanti i Stacionit Policor në Kaçanik,
 3. Përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik,
 4. Përfaqësuesi nga komunitetet etnik pakicë në komunë,
 5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete,
 6. Zyrtari për Barazi Gjinore,
 7. Drejtori i Drejtorisë për Arsim,
 8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit,
 9. Përfaqësuesi i FSK-së,
 10. Përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike,
 11. Kryesuesi i Ekipit Veprues Komunal për Siguri në Bashkësi,
 12. Përfaqësuesi nga Sektori Emergjencave Civile Komunale,
 13. Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
 14. Përfaqësuesi i OJQ-ve lokale,
 15. Përfaqësuesi i mediave lokale,
 16. Përfaqësuesi i bizneseve lokale,
 17. Përfaqësuesi nga komuniteti lokal i personave me aftësi të kufizuara.
3. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është përgjegjës për veprimet dhe detyrat e përcaktuara sipas Udhëzimit Administrative Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.
4. Emrat e përfaqësuesve të KKSB janë si në Listën e hartuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, e cila i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës - MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe anëtarët e KKSB-së.

Me këtë Vendim, njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Anëtarët e KKSB-së njoftohen përmes Zyrës së Kryetarit të Komunës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 - Nr. 400/01-5151/2018
Kaçanik, 28.02.2018

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 9 të Ligjit Nr.05/L-125.- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, si dhe nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë: 28 Shkurt 2018, mori këtë:

V E N D I M
PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE TË PA SHPENZUARA NË BUXHETIN E KOMUNËS
PËR NË VITIN 2018

1. Me këtë Vendim, bëhet bartja e mjeteve të vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2017, në buxhetin e komunës të vitit 2018.
2. Buxheti i Komunës së Kaçanikut i miratuar për vitin 2018 në shumë, **7,737,844.00 euro**, pas bartjes së mjeteve të pa shpenzuara nga viti fiskal 2017 në shumë, **244,455.28 euro**, do të arrijnë shumën e përgjithshme, **7,982,299.28 euro**.
3. Mjetet e pa shpenzuara në shumë prej **244,455.28 euro**, barten si vijon:
 - 3.1. Për Mallra dhe Shërbime shuma prej**5,234.38 euro**;
 - 3.2. Për Shpenzime Komunale shuma prej..... **2.94 euro**;
 - 3.3. Subvencione dhe Transfere shuma prej**8,304.35 euro**; dhe
 - 3.4. Investime Kapitale shuma prej..... **230,913.61 euro**.
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë; Shtojcat A dhe B të pesë (05) pasqyrave tabelave e bilanceve të pa shpenzuara nga viti fiskal 2017 dhe rindarja e mjeteve të bartura në buxhetin e vitit 2018 në Nën-programet përkatëse, kategoritë ekonomike dhe kodet e projekteve.
5. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njëjtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim të njoftohen:

1. Kryetari i Komunës(përmes Zyrës së Kryetarit, njoftohen shërbimet tjera)
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-5065/18
Kaçanik, 28.02.2018

Në bazë të nenit 17(f) dhe 25.2 e Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 4.1, 4.2 dhe 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087-Për Ndërmarrje Publike si dhe Ligjeve për ndryshim plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 04/L-111 të vitit 2012 dhe Ligjit Nr. 05/L-009 të vitit 2015, nenit 6 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 28 Shkurt 2018, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRU "Bifurkacioni" SH.A- Njësia në Kaçanik

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Kompaninë Rajonale të Ujësllësit për KRU "Bifurkacioni" SH.A përkatësisht për Njësinë në Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi, në përbërje prej 03 anëtarëve, 1 (Një) anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës, 2 (Dy) anëtarë emërohen nga Kuvendi i Komunës.
2. Përbërja e Komisionit është :
 - 2.1. Hamid Guri anëtar i KK nga subjekti politik i PDK ,
 - 2.2. Shpend Krusha anëtar i KK nga subjekti politik i LVV , dhe
 - 2.3. Bahri Selimi anëtar nga Ekzekutivi i Komunës.
3. Komisioni Komunal i Aksionarëve për KRU "Bifurkacioni" SH. A- Njësia në Kaçanik, vepron në emër të Komunës së Kaçanikut dhe në përputhje me Ligjin për Shoqërinë Tregtare Nr. 02/L-123 si dhe Ligjit Nr. 04/L-006 për ndryshim plotësimin e këtij Ligjit për Shoqërinë Tregtare i vitit 2011, dhe Ligjeve për Ndërmarrjet Publike dhe Ndryshim Plotësimeve të këtij ligji të vitit 2012 dhe 2015.
 - 3.1. Për mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat i janë përcaktuar me ligj, Komisioni nga pika 3 e këtij Vendimi i përgjigjet Kuvendit të Komunës me Raport me shkrim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Anëtarët e Komisionit;
2. Kryetari i Komunës,
3. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë –dhe përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante, dhe
4. Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-5064/18
Kaçanik, 28.02.2018

Në bazë të nenit 4.1 dhe 4.2 , 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087-Për Ndërmarrjet Publike, e Ligjit si dhe Ligjeve për ndryshim plotësimin e këtij ligji, Nr. 04/L- 111 të vitit 2012 dhe Ligjit Nr. 05/L -009 të vitit 2015, të nenit 5, 12 dhe 14 lidhur me nenin 17 Ligjit Nr. 03L-047 Për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur 28 Shkurt 2018, mori këtë:

V E N D I M

**Për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH.A-
Njësia në Kaçanik**

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia” SH.A për Njësinë në Kaçanik.

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve, për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia” SH.A , përkatësisht për njësinë në Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi, do t'i ketë 3 anëtarë : 1 (Një) anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe 2 (Dy)anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi i Komunës., me këtë përbërje:

- | | |
|----------------------|---|
| 2.1. Afërdita Horuni | anëtar i KK nga subjekti politik i AAK, |
| 3.2. Adnan Reka | anëtar i KK nga subjekti politik i LVV, dhe |
| 3.3. Ukshin Qallaku | anëtar nga Ekzekutivi i Komunës. . |

3 Detyrat e Komisionit Komunal të Aksionarëve janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ligjin për Shoqëritë Tregtare si dhe Ndryshim Plotësimit e këtyre ligjeve dy ligjeve.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

Me këtë Vendim do të njoftohen: Anëtarët e Komisionit komunal të Aksionarëve, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe përmes kësaj drejtorie njoftohet Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastërtia” SH.A-Ferizaj, dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kacanik

01 Nr. 60/01-5056/18
Kaçanik, 28.02.2018

Në bazë të nenit 4 pika 1 dhe 2 lidhur me nenin 5 pika 2 të Ligjit nr. 03L-/087 të Ndërmarrjeve Publike, të nenin 23 Lista 2 e Ligjit nr. 04/L- 111 e Ligjit për Ndryshim Plotësimet e Ligjit nr. 03 L//087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 05/L -009 të vitit 2015 për Ndryshim Plotësimet e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, të nenit 12 lidhur me nenin 17(f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë 28 Shkurt 2018, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale (NPK) "Stacioni i Autobusëve" SH.A- Kaçanik

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale (NPK) "Stacioni i Autobusëve" Sh. A- Kaçanik.
2. Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve", SH.A- Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi do të ketë 3 anëtarë: 1 (Një) anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës dhe 2 (dy) anëtarë emërohen nga Kuvendi i Komunës, në përbërje si vijon:
 - 2.1. Ahmet Luma anëtar i KK nga subjekti politik i PDK,
 - 2.2. Fatijona Kyçyku anëtar i KK nga subjekti politik i LVV,
 - 2.3. Ramadush Osmani anëtar nga Ekzekutivi i Komunës.
3. Detyrat e Komisionit Komunal të Aksionarëve janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike si dhe në Ligjin për Shoqëritë Tregtare si dhe Ndryshim Plotësimet e këtyre ligjeve dy ligjeve.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.
6. Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 104/02-5069/18
Kaçanik, 28.02.2018

Në bazë të nenit 40.2(i) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimit Administrativ 12/2012, për përcaktimin e Emërimit dhe Numërimit të Adresave për Zonat e Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Parcela Kadastrale të Lira, i MMPH-së i datës 03.07.2012, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 28 Shkurt 2018, mori këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE
SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË RRUGËVE LOKALE

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për emërimin, riemërimin dhe shqyrtimin e ankesave të rrugëve lokale të Komunës së Kaçanikut.

2. Komisioni nga pika 1. e këtij Vendimi d të jetë në përbërje prej 5 anëtarëve dhe atë; dy anëtarë i cakton Kryetari i Komunës, tre anëtarë i cakton Kuvendi i Komunës, me këtë përbërje:

2.1. Sali Malsiu	nga PDK	anëtar,
2.2. Shpend Krusha	nga LVV	anëtar,
2.3. Besnik Salihu	nga LDK	anëtar,
2.4. Festim Neziraj	nga Ekzekutivi i Komunës,	anëtar dhe
2.5. Menduh Krasniqi	nga zyrtar i komunës në DESHP	anëtar.

3. Kryetari i Komisionit të zgjidhet nga radhët e veta.

4. Komisioni nga pika 2. e këtij Vendimi ka për detyrë;

4.1. T'i shqyrtoj të gjitha kërkesat, ankesat dhe nevojat të tjera që lidhen me këtë çështje,

4.2. Të emëroj rrugët e paemëruara dhe të zhvilloj të gjitha procedurat në pajtim me Udhëzimit Administrativ 12/2012 - Për përcaktimin e Emërimit dhe Numërimit të Adresave për Zonat e Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Parcela Kadastrale të Lira, i MMPH-së e miratuar me dt. 03.07.2012 dhe

4.3. Rezultatet e arritura në vazhdimësi t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës.

5. Komisioni i përcaktuar është i përkohshëm dhe pas përfundimit të tërësishëm të punës dhe objektivat e tij, pushon së vepruari.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrotjtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.

7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim do të njoftohen: MAPL, Anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 -Nr.464/01-4965/2018
Kaçanik, 28.02.2018

Në bazë të nenit 12,17 dhe 18.1(a) të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare nr. 28/2008 e datës 4 qershor 2008), të nenit 4 të Ligjit 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 52/2009) si dhe Ligjit Nr. 03/L-205 - Për Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 91/2010), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 28 Shkurt 2018, mori këtë :

VENDIM
PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË
PARCELËS KADASTRALE Nr. 00246-0 ZK SOPONICË

1. Me këtë Vendim, shpallet me interes të përgjithshëm –për interes të komunës, patundshmëria Nr. 00246-0 në Zonën Kadastrale në Soponicë, pronë e evidentuar në emër të Esat (Xhemal) Guri nga f. Nikaj.
2. Prona e paluajtshme si në pikën 1. të këtij Vendimi, destinohet për interes të përgjithshëm publik të Komunës, për realizimin e projektit të rëndësisë së veçantë, për zgjerimin e lokacionit për ndërtimin e rrethojës së varrezave të dëshmorëve dhe kjo pronë në asnjë mënyrë nuk mund të tjetërsohen dhe as t'i ndërrohet destinimi pa Vendimin e Kuvendit të Komunës Kaçanik.
3. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas ligjit t'i zhvilloj procedurat e nevojshme të shpronësimit të patundshmërisë së përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
5. Pjesë përbërës e këtij Vendimi është Certifikata e Njesisë kadastrale Nr. P-709-17083-00246-0, me Nr. të lëndës: 941-5622/2018 e datës 22.02.2018 në emër të, Esat Xhemajl Guri nga f. Nikaj, e lëshuar nga Zyra Kadasrale e Komunës.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Urbanizëm, Kadasër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
3. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim,
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, dhe
5. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 -Nr.464/01-4962/ 2018
Kaçanik, 28.02.2018

Në bazë të nenit 12,17 dhe 18.1(a) të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare nr. 28/2008 e datës 4 qershor 2008), të nenit 4 të Ligjit 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 52/2009) si dhe Ligjit Nr. 03/L-205 - Për Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 91/2010), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 28 Shkurt 2018, mori këtë :

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË PARCELËS KADASTRALE Nr. 01507-0, ZK BIÇEC

1. Me këtë Vendim, shpallet me interes të përgjithshëm –për interes të komunës, patundshmëria Nr. 01507-0 në vendin e quajtur “ Guri i Zi” në Zonën Kadastrale në Biçec, e evidentuar në emër të P.SH. Ekonomia Pyjore në Kaçanik.
2. Prona e paluajtshme si në pikën 1. të këtij Vendimi, destinohet për interes të përgjithshëm publik të Komunës, për realizimin e projekteve; Ndërtimin e objekteve publike të cilat objekte nevojiten për sigurimin e shërbimeve shëndetësore, rekreative dhe mbrojtjen e ambientit dhe natyrës dhe kjo pronë në asnjë mënyrë nuk mund të tjetërsohen dhe as t'i ndërrohet destinimi pa Vendim të Kuvendit të Komunës Kaçanik.
3. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas ligjit t'i zhvilloj procedurat e nevojshme të shpronësimit të patundshmërisë së përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
5. Pjesë përbërës e këtij Vendimi është Certifikata e Njesisë Kadastrave Nr. P-70917007-01507-0, me Nr. të lëndës: 941-5622/2018, Zona Kadasrtale Biçec e datës 22.02.2018 e lëshuar nga Zyra Kadasrale e Komunës.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
3. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim,
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, dhe
5. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01.Nr. 06-350/01-35053/17
Kaçanik, 28.02.2018

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 10.2 dhe 10.3 të Ligjit 02/L-26 –Për Tokën Bujqësore, të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 –Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të Propozim Vendimit të DUKMM 06 Nr. 350/01-35050/17 – Për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore të Parcela Kadastrale Nr. 00565-0 –tokë bujqësore –Kullosë e Klasës së 3 (Tretë) në Zonën Kadastrale, Bob, në pronësi të Esat Dema, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 28 Shkurt 2018, mori këtë:

V E N D I M PARAPRAK PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS

1. Me këtë Vendim, merret Vendim Paraprak -Për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore, në Tokë Ndërtimore.
2. Toka me destinim bujqësor e lejuar për ndërrimin e destinimit nga pika 1. e këtij Vendimi, lejohet në parcelën kadastrale **Nr. 00565-0** -tokë bujqësore - Kullosë e Klasës së 3 (Tretë) në sipërfaqe, **1639 m²**, e evidentuara në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme **P-70917048-00565-0** Zona kadastrale Bob, në pronësi të, Esat Dema, destinohet në Tokë Ndërtimore.
3. Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të paguhet në procedurë administrative, sipas dispozitave nënligjore në fuqi që e përcaktojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
4. Para marrjes së vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të kërkohet, Pëlqimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe organet tjera relevante, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërsehi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01.Nr. 06-350/01-5094/18
Kaçanik, 28.02.2018

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 10.2 dhe 10.3 të Ligjit 02/L-26 –Për Tokën Bujqësore, të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 –Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të Propozim Vendimit të DUKMM 06 Nr. 350/01-3094/18 – Për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore të Parcela Kadastrale Nr. 00203-5–tokë bujqësore – Arë e Klasës së 3 (Tretë) në Zonën Kadastrale, Bob, në pronësi të, Kemajl Dema, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 28 Shkurt 2018, mori këtë:

V E N D I M PARAPRAK PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS

1. Me këtë Vendim, merret Vendim Paraprak -Për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore, në Tokë Ndërtimore.
2. Toka me destinim bujqësor e lejuar për ndërrimin e destinimit nga pika 1. e këtij Vendimi, lejohet në parcelën kadastrale **Nr. 00203-5**-tokë bujqësore – Arë e Klasës së 3 (Tretë) në sipërfaqe, **538 m²**, e evidentuara në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme **P-70917008-00203-5** Zona kadastrale Bob, në pronësi të, Kemajl Dema, destinohet në Tokë Ndërtimore.
3. Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të paguhet në procedurë administrative, sipas dispozitave nënligjore në fuqi që e përcaktojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
4. Para marrjes së vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të kërkohet, Pëlqimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe organet tjera relevante, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 06-350/01- 5092/18
Kaçanik, 28.02.2018

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14.1. të Ligjit Nr. 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale, të nenit të nenit 6, 10 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 –Për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, të Propozim Vendimit të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06 Nr. 350/01-5092/2018, Kuvendit të Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më 28 Shkurt 2018, mori këtë :

V E N D I M
PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE
NË TOKË NDËRTIMORE

1. MIRATOHET Propozim Vendimi i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06-350/01-5092/18 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të ngastrave kadastrave me numrat: 183-2; 183-1; 182-0; 180-6; 180-7 Zona Kadastrale Bob, nga Plani Zhvillimor Komunal ku janë Toka Bujqësore në Tokë Ndërtimore.

2. Ky ndërrim i destinimit, bëhet për atë së; kultura e pronave të përcaktuara nuk është bujqësore, por “Tokë tjetër Shpellë” si dhe duke marrë parasysh faktin këto ngastra kadastrale, tashmë është shndërruar në zonë ndërtimore afariste.

3. Parcela Kadastrale si në pikën 1. të këtij Vendimi nga Toka Bujqësore, i ndërrohet destinimi në Tokë Ndërtimore dhe bëhet pjesë përkatëse e PZHK Kaçanik.

4. Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të paguhet në procedurë administrative, sipas dispozitave nënligjore në fuqi që e përcaktojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari dhe Arkiva.

Kryetari i Kuvendit
Kemal Mërseli